



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 1133/2 Prot.

Durrës më, 19/6 / 2024

VENDIM
Nr 18, datë 19.6.2024

"PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT PËR ZGJEDHJET E DATËS 21.06.2024 NË UAMD"

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", të Ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjinale të administratës shtetërore dhe enteve publike", bazuar në Urdhrin nr.101, datë 13.03.2024 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë" të Ministrit të Arsimit Sportit, në Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" miratuar me vendim Senati Akademik nr.29, datë 29.03.2024, KIZ në mbledhjen e datës 19.06.2024,

VENDOSI:

1. Miratimin e Udhëzuesit për zgjedhjet e datës 21.06.2024 ne UAMD, sipas materialit bashkëlidhur ketij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ngarkohen strukturat përkatëse për publikim në faqen web dhe në të gjithë ambientet e godinave përbërese te UAMD-së .

Gentian Koçi

Frida Gjermani

Era Qati

KRYETAR
Ada GASHI



Orion Muçaj

Ervis Bejko

Nevila Mehmeti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr. 1134 Prot.

Durrës, më 19.06.2024

UDHËZIM

Drejtuar Votuesve të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës (personel akademik dhe studentë), gjatë procesit zgjedhor për "Autoritetet Drejtuese dhe Senatit Akademik në UAMD", të datës 21.06.2024, në lidhje me mënyrën e votimit si dhe ushtrimin e të drejtës së votës.

- Nisur nga Rregullorja e Zgjedhjeve të drejtën për të votuar në këtë proces e kanë trupa zgjedhore e përbërë nga Personeli akademik me kohë të plotë dhe Studentët aktiv që ndjekin studimet me kohë të plotë në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve. Çdo zgjedhës duhet të paraqesë para komisionit një nga dokumentet zyrtare të identifikimit të vlefshme të dhëna biometrike (Kartë identitetit ose Pasaportë)
- Neni 4 i Rregullores së Zgjedhjeve në pikat 2 dhe 3 të tij, përcakton procesin e votimit si të lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë. Çdo votues ushtron lirisht të drejtën e votës, si dhe ka të drejtën e një vote të vetme për zgjedhjen e çdo njërit prej autoriteteve ose anëtarëve të organeve drejtuese.
- Gjatë procesit zgjedhor është e ndaluar rreptësisht që kandidatët garues apo mbështetës të tyre të vazhdojnë të bëjnë fushatë. Po kështu është e ndaluar rreptësisht që gjatë procesit zgjedhor të mbahen apo të jenë prezente në mjediset përreth Qendrave të Votimit, materiale të fushatës për cilindo kandidat garues. Personeli i administrimit në njësitë kryesore, Drejtoria e Shërbimeve dhe KZF janë përgjegjës për këtë standard zgjedhor dhe marrin masat për mbarëvajtjen e procesit të votimit.

Në zbatim të nenit 34, "Procedura e Votimit", nenit 35 "Mbyllja e Votimit", nenit 37 "Vleresimi, numërimi dhe nxjerrja e rezultatit", të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për Autoritetet dhe Organet Drejtuese të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të miratuar me Vendim Nr. 29, datë 29.03.2024 të Senatit Akademik të UAMD,

KIZ udhëzon sa më poshtë:

1. Qendra e votimit hapet në orën 8:00 dhe mbyllet zyrtarisht në 16.00, duke patur parasysh zgjatjen e kohës vetëm nëse ka ende votues që gjenden në rradhë në 16.00 dhe vetëm për këta votues. Në këtë rast komisioni mbledh dokumentet identifikues të atyre që janë ende në radhë dhe i thërret ata një nga një deri në përfundim. Pasi voton dhe votuesi i fundit, komisioni merr vendim për mbylljen e procesit.

2. Zgjedhësit qëndrojnë në radhë jashtë qendrës së votimit dhe futen njëri pas tjetrit në qendrën e votimit për të votuar, me thirrjen e një anëtarë të komisionit. Pasi hyn në qendrën e votimit, zgjedhësi thotë emrin e tij, nëse është personel akademik apo student, njësinë bazë ku bën pjesë për trupën zgjedhore personel akademik dhe programin e studimit për trupën zgjedhore student, dhe paraqet para komisionit një nga dokumentet zyrtare të vlefshme të identitetit me të dhëna biometrike: Kartë Identiteti ose Pasaportë të vlefshme.

3. Përdorimi i celularit është kategorikisht i ndaluar brenda Qendrës së Votimit, si nga votuesit ashtu edhe nga vëzhguesit, anëtarët e komisioneve zgjedhore me përjashtim të Kryetarit si koordinator në KIZ.

4. Pas verifikimit nga KZF se të dhënat e identitetit të votuesit përputhen me të dhënat në listën e zgjedhësve dhe se votuesi është i njëjtë me personin në dokumentin e identifikimit, Kryetari shënon në listën e zgjedhësve numrin personal të dokumentit dhe më pas i heq vizë emrit të zgjedhësit në këtë listë.

5. Zgjedhësi që nuk e ka emrin në listën e zgjedhësve dhe është i pajisur nga një Vendim KIZ për të votuar, pasi hyn në qendrën e votimit e paraqet atë tek kryetari i komisionit në atë qendër votimi. Emri i këtij zgjedhësi dhe numri i kartës së identitetit të tij shënohet në librin e protokollit të mbledhjeve, si dhe me shkrim dore në fund të listës së zgjedhësve.

6. Pasi janë kryer këto veprime dhe para se të shkojë në dhomën e fshehtë për të votuar, votuesi nënshkruan në listën e zgjedhësve anash emrit të tij.

7. Fletët e votimit që i jepen votuesit për të votuar janë:

- Në rastin e studentit votues, jepen fletë votimi për:
 - rektor;
 - drejtues njësie kryesore;
 - anëtarë në Senatin Akademik, përfaqësues i studentëve.
- Në rastin kur votuesi është personel akademik i jepen fletë votimi për:
 - rektor;
 - drejtues njësie kryesore;
 - drejtues njësie bazë në të cilën bëjnë pjesë;
 - anëtarë të personelit akademik në Senatin Akademik.

8. Çdo fletë e votimit është e vulosur, në hapësirën që përkon me ndarjen nga një vizë e pandërprerë 5 cm nga fundi i fletës në pjesën e pasme të saj, 2 vula: me vulën KZF dhe vulën KZF Kryetari, të cilat vendosen sa më drejtë.

9. Votuesi (personel akademik apo student) pasi merr fletët e votimit nga komisioni, hyn i vetëm në dhomën e fshehtë:

- Në fletën e votimit për Rektor, Drejtues i Njesisë Kryesore, Drejtues i Njesisë Bazë shënon në krah të emrit të kandidatit njërën nga shenjat **+** ose **×** ose **✓** që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij. Shenja duhet të vendoset vetëm në krah të një emri dhe me stilolapsin që gjendet në dhomën e fshehtë.

- Në rastin kur për autoritet drejtues konkuron vetëm një kandidat, votuesi voton duke shënuar njërën nga shenjat **+** ose **×** ose **✓** që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij, në krah të emrit të kandidatit dhe në njërën nga kutitë, përkatësisht "Pro" ose "Kundër";



- Në fletën e votimit për Anëtarë të Senatit Akademik shënon në krah të emrave të kandidatëve njërën nga shenjat + ose X ose ✓ që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij. Votuesi duhet të shënojë jo më shumë se 4 emra që i përkasin personelit akademik të njësisë kryesore përkatëse, përndryshe fleta e votimit është e pavlefshme. Kur fleta e votimit ka më pak se 4 emra votohet për aq emra sa janë.
 - Në fletën e votimit për Anëtarë të Senatit Akademik për kategorinë Studentë shënon, në krah të emrave të kandidatëve njërën nga shenjat + ose X ose ✓, që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij. Votuesi duhet të shënojë jo më shumë se 2 emra përndryshe fleta e votimit është e pavlefshme.
 - Votuesi përdor njerën nga shenjat + ose X ose ✓, ose cdo lloj shenje tjetër që shpreh qartë vullnetin e tij. Shenjë që i shërben vetëm procesit zgjedhor dhe që nuk e bën votën të identifikueshme. Pra përdor nje shenje dhe jo simbol, figure, shkronjë apo numër.
 - Pasi bën shënimin e tij në fletën e votimit, ai i palos fletët në mënyrë që 2 vulat në pjesën e pasme të fletës të jenë të dukshme, del nga dhoma e fshehtë, i hedh fletët në kutitë përkatëse të votimit, sipas modelit në ballinën e kutisë dhe largohet nga qendra e votimit.
10. Nëse shënimin në fletën e votimit apo në të paktën një nga fletët e votimit bëhet jashtë dhomës së fshehtë, zgjedhësi nuk lejohet të fusë fletën/fletët e votimit në kuti. Kryetari i KZF e merr këtë fletë votimi, shënon në pjesën e pasme fjalët "E dëmtuar" dhe e fut atë në zarfin "Fletë votimi të dëmtuara". Në këtë rast, zgjedhësit i jepet një fletëvotimi tjetër e të njëjtit lloj dhe rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të mbledhjeve të KZF-së. Nëse zgjedhësi shënon përsëri në fletën e votimit jashtë dhomës së fshehtë, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin "Fletëvotimi të dëmtuara" dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi.
11. Nëse zgjedhësi bën shënim ose e dëmton fletën e votimit padashje dhe kërkon një fletëvotimi të dytë, fleta e votimit konsiderohet e dëmtuar dhe futet në zarfin "Fletëvotimi të dëmtuara" dhe zgjedhësit i jepet një fletëvotimi të dytë e të njëjtit lloj. Rasti mbahet shënim në Librin e Protokollit të mbledhjeve të KZF-së. Nëse zgjedhësi shënon ose dëmton përsëri pa dashje fletën e dytë të votimit, edhe fleta e dytë e votimit futet në zarfin "Fletëvotimi të dëmtuara" dhe zgjedhësit nuk i jepet më fletë votimi. Në asnjë rast fletët e votimit të dëmtuara nuk hidhen në kutitë e votimit.
12. Në qendrën e votimit është e ndaluar kategorisht përdorimi i aparateve celulare apo i mjeteve të tjera regjistruese nga ana e votuesve. Votuesi duhet të hyjë në dhomën e fshehtë i pangarkuar me çantë, mjete apo sende, qoftë edhe shkollore, në rast të kundërt KZF-ja merr masat përkatëse.
13. Në qendrën e votimit, gjatë procesit të votimit lejohen të qëndrojnë vetëm:
 - anëtarët dhe sekretari i KZF
 - zgjedhësit që janë duke kryer procedurat e votimit deri në përfundim të tyre;
 - vëzhguesit e akredituar nga KIZ;
 - përfaqësues të MASR
14. Vlerësimi, konstatimi, numërimi i votave dhe nxjerrja e rezultatit zhvillohet sipas radhës së mëposhtme:
 - a. Rektor
 - b. Drejtues i njësisë kryesore
 - c. Drejtues i njësisë bazë/qendrës së kërkimit shkencor

d. Anëtarë të Senatit Akademik (personel akademik dhe studentë)

15. Në qendrën e votimit, gjatë procesit të numërimit të votave kanë të drejtë të qëndrojnë vetëm: - anëtarët dhe sekretari i KZF-së;
- Kandidatët dhe vëzhguesit e tyre të akredituar
- Përfaqësues të MASR

16. Kryetari i KZF në rast të shkeljes së rregullit dhe qetësisë nga pjesëmarrësit e lejuar në të gjatë numërimit ndërpret procesin e numërimit, bën mbledhjen urgjente të KZF dhe merr Vendimin përkatës për personin që ka shkelur standardet zgjedhore. Për Vendimin komunikon me KIZ dhe ky i fundit me Administratorin e UAMD dhe Drejtorinë e Shërbimeve për marrjen e masave për sigurinë dhe rendin në institucion.

17. Çdo kontestim i kandidatëve, apo vëzhguesve të tyre shënohet detyrimisht në librin e protokollit të mbledhjeve nga sekretari i KZF-së.

18. Anëtarët e KIZ në përmbushje të detyrave dhe kompetencave të tyre ndjekin dhe mbikqyrin gjithë procesin zgjedhor.

Komisioni Institucional i Zgjedhjeve, Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës

